

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Muli vë në veprim “Planin B” në SHBA
ADRESA	https://www.gazetatema.net/antena/muli-ve-ne-veprim-planin-b-ne-shba-i584143
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	redirected

KOHA


KAPUR NGA NE	5 shtator 2026, 15:00:58 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	5 shtator 2026, 16:00:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	8f6f142009f53718d2a30cd869a0631fd8fffea43ce22be346024e0fd53608f3
TEKSTI	35ff8fe0d669b90851f7c853021d9211c26774050641eae1afd94a3169f11ae8
PAMJA	4312f78414d5dfd63d26b9b09e212df6cec98fd486c196b778838c37d21142db

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	f09b1a07fc5ba0bd9e19bbc61c459eec7bc39abe1ce3a02cce81b6f646360a73
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	82597d84b51b00d12dc8da6bd19ef563dde476bcf2b8ac3fbaec8c83c315f326
ANKORUAR	Polygon PoS · bllok 46991200
TRANSAKSIONI	0x4a6949f734bb917e86ef48a394a39f5e560c6ca7cb50992564901c0d93c74ab3
IPFS	QmcQ2vpHEy67KT56kkLrEBokuUFGqg7MP3SJ63znFCszpz



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/f09b1a07fc5ba0bd9e19bbc61c459eec7bc39abe1ce3a02cce81b6f646360a73>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)

English

le [Meloni teston rekordin e qeverisjes](#)[Migjeni i rrezikuar](#)[Nis evidentimi i demeve nga zjarri ne Himare](#)[T'avo: Po identifikohen familjet e prekura](#)[Putn urdheron armepush](#)
fundit

Muli vë në veprim “Planin B” në SHBA



5 Shtator 2026, 18:00Antena TEMA

Ajo që kishte frikë Muli ndodhi. Publikimi i vendtakimeve të Doktorit nga Lelo i bëri gjëmën vizitës. Flamingot e SHBA kanë marrë adresat dhe janë organizuar t'i shkojnë para takimit.

I pari e dha alarmin Zekriu. Ai njoftoi Mulin se duhet të ndryshojë vendin e takimit me Doktorin, pasi ia kanë zbuluar dhe po bëhen gati t'i bëjnë antimiting.

-Po ku do ta bëjmë, i tha Muli.

-Po mundohem, i tha Zekriu. Kam një shok nga Kukësi, që ka pasur me qira një kafe dhe byrektore në Bronx, por e ka lënë vitin e kaluar, e ka një meksikan. Do flas me të dhe Doktorin do shkojë për kafe aty. Tek pjesa e pasme e klubit ka një derë që hyn nga pas, që e përdorin për furnizim. Kështu që takimin fillestar mund ta bëjmë aty.

-Po takimin e madh?

-Atë po mundohem të sigurojmë një sallë sikur e kanë marrë republikanët. Do ta rezervojmë në emër të Fatmir Mediut, do t'i themi është kryetar i Partisë Republikane në Albani.

Albania është kryeqyteti i shtetit New York dhe ata mund të besojnë se është i këtushëm. Kështu që shqiptarët nuk e dinë që është takim i Doktorit.

Këta tanët i njoftojmë në grup WhatsApp.

-Shumë mirë, tha Muli. Po në Teksas?

-Aty prapë e pret Mediu. Aty është situata nën kontroll se s'ka shumë flamingo se kanë fituar republikanët. Këtu na prish punë vetëm Belo që ngjan me Mandamin. Ai duhet të rregullojë pak mjekrën. Të paktën ta bëjë si Fuga.

-S'ka problem se e qeth Doktorin si të duash, i tha Muli.

-Në New Jersey e ke situatën më mirë se kemi një lokal kuksianësh, jo atë timin, tha Zekriu. Hapim fjalë që do bëhet tek imi, që flamingot të shkojnë aty, dhe e bëjmë tek ai tjetri. Do vijë dhe ai tropojani që ka paguar 6 milionë euro për La Civitën, por i është thyer celulari dhe po kërkonte të blinte një të përdorur se është pak hollë me lekët këtë muaj. Sa ta gjejë, do na marrë në telefon.

-E, shumë mirë, tha Muli. Se nuk jam vetë aty, se i kisha rregulluar vetë. Për çdo pagesë do flasësh me këtë pronarin e Syrit, se ai i ka lekët.

-Bela e madhe, tha Lelo. Na zunë mallkimet e Taos që po donim t'i prishnim takimet në diasporë. Por kjo është shenjë që do fitojmë thellë, se dhe Tao fitoi thellë në diasporë, tha Lelo.



Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Muli merr masat për antimitingun ndaj Doktorit

17:39 Antena / 4 komente

Muli dyshon se Doktor i ka mbyllur Facebook-un Gonit

19:37 Antena / 3 komente

I elo kërkon nga Doktor i të disiplinohen laimet në vizitën në SHRA

19:52 Antena / 1 koment

[Muli publikon axhendën e takimeve të Doktorit në SHBA](#)

19:53 Antena / 8 komente



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.